



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.53, datë 01.08.2023

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“STRUKTURA SHËRBIMI ME FUNKSION MAGAZINIMI DHE TREGTIMI 1-3 KATE”,  
ME VENDNDODHJE NË KASHAR, BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të neneve 7, shkronja “ç”, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Astral” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Struktura shërbimi me funksion magazinimi dhe tregtimi 1-3 kate”, me vendndodhje në Kashar, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Astral” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

